

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/C/132/2011
26/10/2011

URDHËR

(1) In the 9 (nëntë) kërkesat e përmendura në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, me përjashtim të kërkesave nr. 00065 dhe 24486, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, ka dëshmuar pronësinë për pronën e kërkuar;

(2) Në kërkesën nr. 00065, të referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore sipas rastit, ka dëshmuar pronësinë për objektin komercial dhe të drejtën e shfrytëzimit për tokën e bashkuar atij;

(3) Në kërkesën nr. 24486, të referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Prej datës së shkatërrimit të pronës komerciale bartësi i së drejtës pronësore, përmbushi kërkesat për vërtetimin e pronësisë për pronën e kërkuar;

(4) Në kërkesën nr. 01214, të referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Mbajtësi i së drejtës pronësore ka dëshmuar të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar ;

- (5) Në secilën prej 11 (njëmbëdhjetë) kërkesave të identifikuar në paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) më sipër, më përjashtim të Kërkesës nr. 13404, Komisioni urdhëron*

Urdhëron që

- (a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i tokës së bashkuar mbi të cilën ishte ngritur prona banesore ;*
 - (b) Çdo person tjetër, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe*
 - (c) Nëse çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.*
- (6) Komisioni më tutje vendos që kërkesat nr. 00108, 14549, 24486 dhe 33371 të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensimin për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar.*
- (7) Në 5 (pesë) kërkesat e referua në pjesën F të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.*
- (8) Në 7 (shtatë) kërkesat e referua në pjesën D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e pestë nga 24 deri 26 tetor 2011 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej njëzet e dy kërkesa për pronë komerciale në seancën e njëzetë e pestë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuar të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

7. Ky vendimi zbatohet për njëzet e dy kërkesat komerciale paraqitura Komisionit gjatë seancës së njëzet e pestë. Në secilin prej këtyre kërkesave, paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës pronësore, me përjashtim të kërkesës nr. 01214 dhe 10543, në të cilën paraqitësi i kërkesës kërkon kthimin e të drejtës së shfrytëzimit. Në kërkesën nr. 24486 paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës pronësore për pronën komerciale e cila, në kohën e notifikimit, u gjet e shkatërruar tërësisht.

8. Komisioni vëren më tej se tetë kërkesat e identifikuar në pjesët A, C dhe D të listës së bashkangjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

9. Komisioni vëren më tej se katërmëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesët B, E dhe F të listës së bashkangjitur, janë kontestuese në kuptimin se pala që uzurpon pronat e kërkuara ("Pala përgjegjëse") ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, palës përgjegjëse i është ofruar një kopje e kërkesës të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Në përputhje me nenin 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësit të kërkesës, i është ofruar një kopje e dokumenteve të siguruar nga pala përgjegjëse në përgjigje të kërkesës. Si paraqitësit të kërkesës ashtu edhe palës përgjegjëse u është dhënë mundësia për të komentuar për informacionin e ofruar nga palët kundërshtuese dhe komentet apo informacioni i tillë janë marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes së kërkesës.

A. Kërkesa të miratuara.

10. Në kërkesat e përmendura në pjesët A, B dhe C të listës së bashkëngjitur, Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë, vendimet për trashëgiminë, kontrata për bashkimin e mjeteve, fletët poseduese, kontratat e shfrytëzimit, certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme, kontratat e shitblerjes, vendimi i ndarjes dhe vendimet e gjykatës për njohjen e pronësisë. Komisioni është i kënaqur se vendimet e gjykatës së formës së prerë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme që konfirmojnë interesin pronësor me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Dokumentet e tjera të dorëzuara nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese dhe kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Nuk është marrë ose nuk është kërkuar *ex officio* nga Sekretaria asnjë provë që do të kundërshtonte supozimin e të drejtës pronësore. Rrjedhimisht, Komisioni është i kënaqur me faktin se dokumentet e dorëzuara provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave për pronat e kërkuara. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen si relevante.

1. Kërkesat nr. 13010, 24476, 33071 dhe 33371

11. Në kërkesat nr. 13010, 24476, 33071 dhe 33371, të referuara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në bazë të konstatimeve të Komisionit në paragrafin 11 më sipër, kërkesat duhet të miratohen.

2. Kërkesa nr. 00108 dhe 24486

12. Në kërkesën nr 00108 dhe 24486, të referuar në pjesën A të listës së bashkëngjitur, bartësi i së drejtës pronësore është e përfaqësuar nga një person i autorizuar fizik. Komisioni ka vendosur që individi i autorizuar ka autorizim të vlefshëm dhe të bërë në mënyrë të rregullt në pajtim me nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me ligjin nr. 03/L-079. Kështu duhet të miratohet vendimi që konfirmon të drejtën e pronësisë në favor të bartësit të së drejtës pronësore për këto kërkesa.

3. Kërkesa nr. 00065

13. Në kërkesën nr 00065, të referuar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se ai e bleu pronën e kërkuar (një dyqan) nga ushtria jugosllave në janar 1999. Në pajtim me kontratën e blerjes, e cila është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës ka fituar pronësinë për objektet komerciale dhe të drejtën e përhershme të shfrytëzimit për token, ndërsa pronësia e tokës mbetet e Komunës së Mitrovicës. Paraqitësi i kërkesës e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në shtator 1999, kur ai u detyrua të largohet nga prona nga persona të panjohur.

14. Pala përgjegjëse e kërkesës është Kuvendi Komunal i Mitrovicës. Pala përgjegjëse pretendon se pronësia e dyqanit është transferuar në vitin 2003 me vendim administrativ të vetë Kuvendit Komunal nga Ushtria Kombëtare Jugosllave tek Kuvendi Komunal, në bazë të nenit 3 të Ligjit për Regjistrimin e Pasurive të Patundshme në Pronësi Shoqërore (Gazeta Zyrtare e KAS të Kosovës 37/71).

15. Bazuar në provat para tij, Komisioni konstaton se, ndonëse Komuna ka mundur në mënyrë të vlefshme të transferojë pronësinë e tokës, ajo nuk ka mundur në mënyrë të vlefshme të transferojë pronësinë e dyqanit, pasi me anë të kontratës së blerjes të datës 29 janar 1999 ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe ushtrisë, ushtria nuk është më pronar i pronës së kërkuar. As Komuna nuk mund të shuajë në mënyrë të vlefshme të drejtën e shfrytëzimit të paraqitësit të kërkesës për tokën e bashkuar, të cilën paraqitësi i kërkesës e ka fituar në bazë të kontratës së blerjes. Kështu, Komisioni konfirmon pronësinë e paraqitësit të kërkesës për objektin e kërkuar komercial (dyqan) dhe të drejtën e shfrytëzimit për tokën.

4. *Kërkesa nr. 13404*

16. Në kërkesën nr 13404, e referuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, pra si bashkëpronar i objekteve të kërkuara komerciale, të cilat janë duke u shfrytëzuar si restorant. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë blerje ndërmjet paraqitësit të kërkesës, një bashkëpronari tjetër të pronës dhe shitësit, kompania e ndërtimit "Grading", datë 11 Maj 1992. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar kontratën e blerjes si të vërtetë.

17. Pala përgjegjëse, i cila aktualisht ka uzurpuar pronën objekt i juridiksionit të Komisionit, deklaron se në vitin 2004 paraqitësi i kërkesës dhe bashkëpronari bënë padi kundër tij duke kërkuar riposëdimin. Sipas palës përgjegjëse, kjo procedura është ende në pritje për gjykim pranë Gjykatës Komunale. Paraqitësi i kërkesës vërteton se me të vërtetë padia është ende në pritje për gjykim.

18. Komisioni vëren se, në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, kërkesat për të cilat procedura gjyqësore ka filluar para hyrjes në fuqi të rregullores, dmth, 16 tetor 2006, janë të përjashtuara nga juridiksioni i Komisionit. Megjithatë, në rastin në fjalë, edhe pse procedimi gjyqësor ka filluar para datës kritike, ky procedim ka të bëjë thjesht me riposëdimin dhe jo me vërtetimin e pronësisë, i cili është mjeti ligjor i kërkuar me këtë kërkesë. Komisioni konstaton se, në këto rrethana, përjashtimi në nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 nuk zbatohet. Kështu, kërkesa duhet të miratohet dhe të konfirmohet e drejta pronësore e paraqitësit të kërkesës për pjesën ideale prej $\frac{1}{2}$ të pronës së kërkuar. Megjithatë, duke qenë se kërkesa për riposëdimin është në pritje para gjykatës lokale, Komisioni konsideron se ky element i kërkesës të paraqitësit të kërkesës bie jashtë juridiksionit të tij dhe për rrjedhojë duhet të hidhet poshtë.

5. *Kërkesa nr. 44118*

19. Në kërkesën nr 44118, referuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë blerje të datës 12 shkurt 1992 në lidhje me pronën e kërkuar, lidhur ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe Ministrisë Jugosllave të Mbrojtjes. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar kontratën si të vërtetë. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se prona e kërkuar ishte garazh, megjithatë, prona është konvertuar më pas në dyqan.

20. Pala përgjegjëse, i cili është uzurpuesi aktual i pronës së kërkuar, pohon se e ka blerë pronën si garazh, së bashku me një banesë. Pala përgjegjëse paraqiti një kontratë blerje në lidhje me banesën, e datës 9 maj 2002 në mes vëllait të palës përgjegjëse Naim Kuqi dhe Miodrag Stevanoviçit si shitës. Megjithatë, Komisioni vë në dukje se kontrata e blerjes i

referohet një prone banesore të ndryshme nga prona e kërkuar komerciale dhe nuk përmend garazhin.

21. Rrjedhimisht duhet të miratohet vendimi që konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore, siç përcaktohet më sipër.

6. Kërkesa nr 01214

22. Në kërkesën nr. 01214, e referuar në pjesën C të listës bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë anëtarit të bashkësisë familjare, pra bija e bartësit të së drejtës pronësore, duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit të babait të saj për një dyqan.

23. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë shfrytëzimi në emër të atit të saj në lidhje me pronën e kërkuar, të datës 1 mars 1984. Kontrata është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vlefshme. Asnjë palë përgjegjëse nuk ka kontaktuar Sekretarinë Ekzekutive për të kundërshtuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Rrjedhimisht duhet të miratohet vendimi që konfirmon të drejtën e shfrytëzimit në favor të bartësit të së drejtës pronësore, siç përcaktohet më sipër.

B. Kërkesa të hedhura poshtë ose të refuzuara.

24. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

25. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

26. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

27. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me

kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

28. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

1. *Kërkesa nr. 00442*

29. Kërkesa nr. 00442 është paraqitur nga një person i autorizuar në emër të paraqitësit të kërkesës, i cili është bartësi i pretenduar si së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se e ka blerë pronën në vitin 2002 dhe pranon se ai kurrë nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar dhe se nuk e ka humbur posedimin e pronës si rezultat i konfliktit të armatosur në vitin 1998/99. Në këto rrethana kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

2. *Kërkesa nr. 00278*

30. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesën në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ajo e ka blerë pronën, një dyqan, në vitin 2005. Paraqitësi i kërkesës nuk pohon se ajo e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i konfliktit të armatosur në vitin 1998-1999 dhe në të vërtetë, nisur nga data e humbjes, nuk mund të ketë bazë faktike për një pretendim të tillë. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

3. *Kërkesat nr. 08655, 10543, 11529, 48050, 48051, 48052 dhe 49216*

31. Në kërkesat nr. 08655, 10543, 11529, 48050, 48051, 48052 dhe 4921, të cilat janë depozituar nga pesë paraqitës të ndryshëm të kërkesës, paraqitësit e kërkesës kërkojnë të drejta të ndryshme pronësore dhe mjete ligjore për gjashtë dyqane të ndryshme të cilat janë të vendosura në të njëjtën parcelë, e cila i takon Komunës së Klinës.

32. Në kërkesën nr. 08655 dhe 10543 paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe riposedimin e një dyqani, i cili u ngrit në bazë të një vendimi të përkohshëm për ndarjen i lëshuar më 19 shkurt 1996 nga Komuna e Klinës.

33. Komisioni vëren se vendimi për ndarjen i lëshuar nga Komuna ishte e një karakteri të përkohshëm, për një periudhë prej dy vjetësh, dhe i kufizuar për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një strukture të parafabrikuar në tokën komunale dhe si e tillë nuk e lejonte shfrytëzuesin të ndërtonte një objekt (të paluajtshëm) të përhershëm. Megjithatë, në shkelje të lejes, paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 08655 dhe 10543 ndërtoi atë që duket të jetë një strukturë e përhershme, një dyqan. Pasi nuk ka prova të ofruara nga paraqitësi i kërkesës i cili do të tregonte se e drejta e shfrytëzimit e paraqitësit të kërkesës është vazhduar përtej periudhës dy vjeçare të përcaktuar në vendimin e përkohshëm për ndarjen të vitit 1996, atëherë e drejta e

shfrytëzimit e paraqitësit të kërkesës konsiderohet të ketë pushuar më 18 shkurt 1998. Kështu, në mungesë të një të drejte pronësore të vlefshme, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të refuzohet.

34. Kërkesat nr. 48050, 48051 dhe 48052 janë depozituar nga dy paraqitës të ndryshëm të kërkesave. Kërkesa nr. 48050 është parashtruar nga Golub Zhivkoviç dhe kërkesat nr. 48051 dhe 48052 nga Sasa Zhivkoviç. Paraqitësit e kërkesës kërkojnë pronësinë për objektet tregtare (dyqane) të cilat gjenden në parcelën e njëjtë. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, Paraqitësit e kërkesës ofruan kontratat e blerjes në mes secilit prej tyre dhe ndërmarrjes "BK Company" për shitjen e pronave të kërkuara, datë 24 janar 1995. Kontratat e blerjes nuk janë vërtetuar nga Gjykata Komunale dhe paraqitësit e kërkesave pranian se kontratat nuk janë formalizuar në gjykatë. Paraqitësve të kërkesave iu kërkuar që të paraqesin prova të mëtijshme për pretendimet e tyre të pronësisë, por ata të dy nuk arritën ta bëjnë këtë. Komisioni konstaton se Paraqitësit e kërkesave nuk demonstrojnë të drejtën e pronësisë për pronat e kërkuara dhe të tre kërkesat duhet të refuzohen.

35. Në kërkesën nr. 49216 paraqitësi i kërkesës pretendon se atij i është dhënë e drejta e përhershme e shfrytëzimit për tokën komunale dhe leja për të ndërtuar një strukturë të përhershme mbi tokë. Në mbështetje të kërkesës paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të ndryshme, duke përfshirë vendimet për ndarjen dhe vendimet e Kuvendit Komunal. Asnjë nga dokumentet e ndryshme të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës nuk u verifikua si e vërtetë nga ana e Sekretarisë Ekzekutive. Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të provojë të drejtën e tij të pretenduar të pronësisë për pronën e kërkuar dhe kërkesa duhet të refuzohet.

36. Në kërkesën nr. 11529 paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për mos shfrytëzimin e objektit komercial (dyqan) për të cilën ai pretendon të ketë të drejtën e shfrytëzimit, për shkak të konfliktit. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tillë kompensimi. Kështu, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

4. Kërkesa nr. 14499

37. Kërkesa nr. 14499 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Bashkëshortja e paraqitësit të kërkesës konfirmon se prona i ishte shitur palës përgjegjëse në vitin 2007. Fakti se paraqitësi i kërkesës ka qenë në gjendje për të shitur pronën tregon se ai është në gjendje për të ushtruar të drejtat pronësore dhe rrjedhimisht nuk mund të thuhet ka humbje të së drejtës pronësore si rezultat e konfliktit. Komisioni më tej vëren se paraqitësi i kërkesës gjithashtu kërkon kompensim për mos shfrytëzim të objektit tregtar (dyqan) si rezultat i konfliktit. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tillë kompensimi. Kështu, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

5. Kërkesa nr. 44635

38. Kërkesa nr. 44635 u paraqitet nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ofroi një kontratë për bashkimin e mjeteve midis tij dhe ndërmarrjes "Gradjenivar - Kralevo" në lidhje me ndërtimin e pronës së kërkuar e vitit 1996. Kontrata nuk është vërtetuar në gjykatë dhe në këtë mënyrë nuk është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për pagesën e çmimit të blerjes. Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të provojë të drejtën e pretenduar të pronësisë për pronën e kërkuar dhe kërkesa duhet të refuzohet.


C. Kërkesa për kompensim

39. Në kërkesat nr. 00108, 14549, 24486 dhe 33371, të referuara në kolonat përkatëse të pjesëve A dhe D të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës kërkon gjithashtu përveç pronësisë, kompensimin për demin fizik ose për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK/REG-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Për rrjedhojë kërkesat duhet të hidhen poshtë.

D. Vërejtje përmbledhëse

40. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

41. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA33071	KPA13010	KPA33371	KPA00108	KPA24486	KPA24476	
----------	----------	----------	----------	----------	----------	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA00065
KPA13404
KPA44118

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA01214

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part D/Pjesa D/Deo D

KPA14549

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part E/Pjesa E/Deo E

KPA10543	KPA44635	KPA48050	KPA48051	KPA48052	KPA49216	
----------	----------	----------	----------	----------	----------	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part F/Pjesa F/Deo F

KPA00442	KPA00278	KPA00613	KPA11529	KPA14499	KPA08655	
----------	----------	----------	----------	----------	----------	--